



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E  
PROJEKTEVE STRATEGJIKE,  
EVROPËS, MIGRACIONIT, DIASPORËS,  
KOMUNIKIMIT DHE TRANSPARENCËS

Nr. 12569 Prot.

Lezhë, më 16 / 7 /2024

V E N D I M

Nr. 279 ., datë 16 / 7 /2024

**“PËR  
MIRATIMIN E PAKETËS SË PLOTË NË KUADËR TË THIRRJES  
SË GJASHTË PUBLIKE PËR PROJEKT PROPOZIME NË  
PROGRAMIN RAJONAL PËR DEMOKRACINË VENDORE NË  
BALLKANIN PERËNDIMOR (ReLOaD 2)”**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” Neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë” pika 1.1 shkronja (b), Vendimi Nr. 393., datë 18.07.2022 “ Për miratimin e rregullores mbi organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Lezhë”, VKB Nr. 211., datë 31.10.2017 “Për miratimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) dhe Bashkisë Lezhë si dhe miratimin e metodologjisë për alokimin e fondeve për organizatat e shoqërisë civile” pika 2 “Të miratohet Metodologjia LOD për alokimin e fondeve për Organizatat e Shoqërisë Civile, të propozuar nga UNDP dhe të miratuar nga Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë”, “Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara dhe Bashkisë Lezhë” Nr. Prot 17007 ., datë 22.09.2021, Urdhërin 255 datë 27.05.2024 “Për krijimin e grupit të punës për kryerjen e procedurave për hapjen e thirrjes së 6-të të programit ReLOaD2 të financuar nga Bashkia Lezhë, VKB Nr. 70, datë 14.12.2023 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe Buxhetit Vjetor për vitin 2023”, Procesverbalin me Nr.1 me Nr.8009/1 Prot., datë 13.6.2024 “përcaktimin e prioriteve të thirrjes 6-të të programit ReLOaD, Proceverbalin Nr. 2 me Nr. 8009/2 Prot., datë 25.6.2024 “Për diskutimin e prioritetëve me OSHC-të për thirrjen e Gjashtë të programit ReLOaD2, financuar nga Bashkia Lezhë” dhe Procesverbalin Nr. 3 me Nr. 8009/3 Prot., datë 11.7.2024 “Për miratimin e prioritetëve dhe paketës së plotë për thirrjes se gjashtë të programit ReLOaD 2, financuar nga Bashkia Lezhë”;

## VENDOSI:

1. Miratimin e prioriteteve në kuadër të Thirrjes së Gjashtë Publike për Projekt Propozime në Programin Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD 2).
2. Miratimin e paketës së plotë në kuadër të Thirrjes së Gjashtë Publike për Projekt Propozime në Programin Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD2), si më poshtë:
  - Shtojca 6** Udhëzuesi;
  - Shtojca 7** Projekt Propozimi;
  - Shtojca 8** Buxheti;
  - Shtojca 9** Korniza Logjike;
  - Shtojca 10** Plani i Aktiviteteve dhe dukshmërisë;
  - Shtojca 11** Formulari i identifikimit administrativ dhe financiar;
  - Shtojca 12** Deklarata për plotësimin e kriterëve;
  - Shtojca A** Deklarata e partneritetit;
  - Shtojca B** Deklarata për shmangien e konfliktit të interesit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
Pjerin Ndreu

